



[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 4

Tiranë – E hënë, 31 janar 2022

## PËRMBAJTJA

|                                                                         | Faqe                                                                                                                                                                                                                                 |
|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kërkesë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 362/2, datë 20.1.2022 | Për publikimin e thirrjes për projektpropozime në fushën e turizmit..... 3                                                                                                                                                           |
| Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 24.1.2022        | Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit..... 8 |





**KËRKESE**  
Nr. 362/2, datë 20.1.2022

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR PROJEKTPROPOZIME NË FUSHËN E TURIZMIT**

**ANEKSI 1**  
**FORMULARI I APLIKIMIT**  
**PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT**

**PJESA I**  
**INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

|                                                                                                                                                         |                                                                                                                                   |                          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| <b>Titulli i Projektit</b>                                                                                                                              |                                                                                                                                   |                          |
| <b>Prioriteti i thirrjes ku aplikohet</b>                                                                                                               | <b>PRIORITETI 1</b><br>(Klikë kutinë)                                                                                             | <input type="checkbox"/> |
|                                                                                                                                                         | <b>PRIORITETI 2</b><br>(Klikë kutinë)                                                                                             | <input type="checkbox"/> |
| <b>Emri i aplikantit</b>                                                                                                                                |                                                                                                                                   |                          |
| <b>Statusi ligjor</b><br>(së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës nr.) | Numri i vendimit dhe data e regjistrimit në Gjykatë;<br>NIPT-i<br>Emri i Bankës<br>Numri IBAN<br>Nr. i llogarisë bankare (në lek) |                          |
| Adresa:                                                                                                                                                 |                                                                                                                                   |                          |
| E-mail:                                                                                                                                                 |                                                                                                                                   |                          |
| Website:                                                                                                                                                |                                                                                                                                   |                          |
| Kohëzgjatja e Projektit                                                                                                                                 | <datë/muaj nga/ deri>                                                                                                             |                          |
| Vendi/et ku zbatohet Projekti                                                                                                                           |                                                                                                                                   |                          |
| Personi i kontaktit                                                                                                                                     |                                                                                                                                   |                          |
| Funksioni                                                                                                                                               |                                                                                                                                   |                          |
| Buxheti total                                                                                                                                           |                                                                                                                                   |                          |
| Fondet e kërkuara nga MTM-ja                                                                                                                            |                                                                                                                                   |                          |
| Informacion për bashkëfinancim                                                                                                                          |                                                                                                                                   |                          |
| Partnerët e Projektit                                                                                                                                   |                                                                                                                                   |                          |

**PJESA II**  
**PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

**Titulli i Projektit:**

**Qëllimi i Projektit:** Përshkruani shkurtimisht Projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si Projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (maksimumi 10 rreshta):

[Shpjegoni ...]

**Objektivat e Projektit** (maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv):

1. [Shpjegoni ...]

2. [Shpjegoni ...]

3. [Shpjegoni ...]

Etj.

**Aktivitetet kryesore të Projektit** (maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet, të planifikuara në çdo fushë):

1. [Shpjegoni ...]

2. [Shpjegoni ...]

3. [Shpjegoni ...]

Etj.

**A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura?** (Maksimumi 5 rreshta):

[Shpjegoni ...]

**A është Projekti/produkti objektivisht i verifikueshëm lidhur me rezultatet e**



**aktiviteteve?** (maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):

Aktiviteti 1:

Projekti/Produkti rezultatet e pritura dhe treguesit lidhur me: [Shpjegoni ...]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni ...]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni ...]

\* Plotëso tabelën për aktivitetet/nënaktivitetet e Projektit.

| Aktiviteti<br>(përshkrimi) | Qyteti | Vendi/<br>data/ora | Periudha | Fusha/<br>gjinia | Nr. i audiencës<br>(parashikim) | Nr. i personave të angazhuar<br>(pagesa honorar) | Partneri<br>zbatues |
|----------------------------|--------|--------------------|----------|------------------|---------------------------------|--------------------------------------------------|---------------------|
|                            |        |                    |          |                  |                                 |                                                  |                     |

#### Shënim:

- Ju lutem, shënoni **aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkojnë.

**Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara?** (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblodhur, se cili është grupi parësor i synimit të Projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e Projektit.) (maksimumi 5 rreshta): [Shpjegoni ...]

**Qëndrueshmëria e Projektit** – impakti afatgjatë i Projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të Projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

**Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e Projektit, a është respektuar e drejta e autorit?**

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

### PJESA III PARTNERËT (Nëse ka)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve, duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e Projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

#### Partneri 1 (aplikanti)

Misioni: Cili është misioni i organizatës suaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

**Struktura.** Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

**Financimi.** Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

#### Partneri 2

Emri organizatës: [Shpjegoni ...]

Personi i kontaktit: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Faqja në internet: \_\_\_\_\_

Etj.

### PJESA IV BUXHETI

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e Projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruara dhe të mundshme?



## ANEKS 1.1

Emri i aplikantit:

Titulli i Projektit:

Koha e zbatimit: nga/deri

| Nr.                                                      | Lloji i shpenzimit                                                                                                                 | Njësia | Sasia | Çmimi në Lekë | TOTAL    | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | Vetë aplikanti | Donatorët e tjerë -I- | Donatorët e tjerë -II- |
|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|---------------|----------|-----------------------------------|----------------|-----------------------|------------------------|
| <b>SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZËRAVE PËRKATËS</b> |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| <b>1</b>                                                 | <b>Titulli i shpenzimit</b>                                                                                                        |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
|                                                          | <i>Shembull: Promocion dhe përgatitje (ftesa, poster, baner, programi) të specifikuara sipas përshkrimit të eventit dhe vendit</i> |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 1.1                                                      | Dizajni i ftesës                                                                                                                   |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 1.2                                                      | Printime                                                                                                                           | cope   | 100   | 200.00        | 2,000.00 |                                   |                |                       |                        |
| 1.3                                                      | etj                                                                                                                                |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
|                                                          | <b>TOTAL 1</b>                                                                                                                     |        |       | 200.00        | 2,000.00 |                                   |                |                       |                        |
| <b>2</b>                                                 | <b>Realizimi i aktivitetit</b>                                                                                                     |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 2.1                                                      | Shpenzime salle                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 2.2                                                      | Shpenzime akomodimi                                                                                                                |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 2.3                                                      | etj                                                                                                                                |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
|                                                          | <b>TOTAL 2</b>                                                                                                                     |        |       | -             | -        |                                   |                |                       |                        |
| <b>3</b>                                                 | <b>Titulli 3</b>                                                                                                                   |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 3.1                                                      |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 3.2                                                      |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 3.3                                                      |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
|                                                          | <b>TOTAL 3</b>                                                                                                                     |        |       | -             | -        |                                   |                |                       |                        |
| <b>4</b>                                                 | <b>Titulli 4</b>                                                                                                                   |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 4.1                                                      |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 4.2                                                      |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
| 4.3                                                      |                                                                                                                                    |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |
|                                                          | <b>TOTAL 4</b>                                                                                                                     |        |       | -             | -        |                                   |                |                       |                        |
|                                                          | <b>TOTALI I SHPENZIMEVE (në Lekë dhe në %)</b>                                                                                     |        |       |               |          |                                   |                |                       |                        |

Ju lutem shtoni linja buxhetore për çdo aktivitet.

**Sqarim:**

- Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe vetë aplikantin, si % e buxhetit total për Projektin.

- Vlerat financiare të paraqitura në këtë formular, duhet të jenë të përcaktuara në lek.

- Çmimet e parashikuara duhet të jenë me TVSH.

**ANEKSI 2**  
**PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E**  
**MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR**  
**ME PROJEKTET NË FUSHËN E**  
**TURIZMIT**

**1. THIRRJA PËR APLIKIM**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendës apo të huaj, privatë ose publikë, të cilët kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, në funksion të realizimit të misionit strategjik:

*“Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit”*



Thirrja synon promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike, nëpërmjet zhvillimit të turizmit malor, natyror dhe kulturor, turizmit kulinar, enoturizmit, turizmit nostalgjik, turizmit të aventurës etj.

Thirrja do të qëndrojë e hapur nga data **24 janar deri më datën 23 shkurt, të vitit 2022**. Projektet duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, gjatë periudhës 24 mars deri më 1 dhjetor 2022.

Prioritetet e thirrjes për mbështetje financiare të projekteve në turizëm, janë:

1. Promovimi i destinacioneve, zhvillimi i produkteve turistike dhe brandimi i territorit;
2. Digjitalizimi dhe inovacioni.

### PRIORITETI 1

Promovimi i destinacioneve turistike e vlerave të veçanta, zhvillimi i produkteve dhe i atraksioneve turistike të turizmit malor, rural, shtigjeve, agroturizmit, enoturizmit, aventurës, monumenteve të natyrës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në industrinë e mikpritjes.

*\* Tipologjia e aktiviteteve, që synojnë arritjen e prioritetit 1, renditen si më poshtë, **por** janë vetëm shembuj të cilët nuk kufizojnë tematika të tjera objekt të këtij prioriteti:*

a) *Promovimi i destinacioneve turistike, marketimi apo brandimi i territorit*, nëpërmjet guidave turistike, webside-ve, mediave sociale, videove promionale, veprimtarive me karakter aventuror dhe kulturor, materialeve karakteristike/tradicionale të zonave etj.;

b) *Promovimi i produktit turistik*, sipas karakteristikave të destinacioneve turistike, duke përfshirë komunitetet lokale, krijimin e shtigjeve malore, të çiklizmit dhe jo vetëm, krijimin e tureve/paketave demonstruese të procesit të realizimit të produkteve tradicionale, si dhe/apo përfshirjen në proces të turistit etj.;

c) *Promovimi i produkteve turistike tematike, që lidhen me produkte, të tilla si:* oferta e itinerare/rrugë turistike, kulturore, duke u fokusuar në aktivitete sportive dhe/ose sinergjinë e zonave natyrore/trashëgimisë kulturore ose industriale;

d) *Promovimi i peizazheve natyrore* për qëllime turistike, nëpërmjet identifikimit dhe zhvillimit të vendeve panoramike, fenomeneve të veçanta natyrore, burime të veçanta natyrore, aktiviteteve në natyrë etj.;

e) *Promovimi i kulinarisë* si atraksion turistik, në funksion të turizmit kulinar;

f) *Promovimi i “Verës shqiptare”*, në funksion të enoturizmit, duke organizuar evente/net degustimi për promovimin e verërave shqiptare;

g) *Promovimi i “Specieve endemike” të florës dhe të faunës shqiptare*, në funksion të promovimit të turizmit;

h) *Promovimi i “Turizmi i kujtesës”*, identifikimi dhe rritëzimi për të kthyer në atraksione turistike, objekte apo veprimtari që i përkasin një periudhe historike, si: punishte, tunele, bunkerë etj.;

i) *Promovimi i produkteve turistike të aksesueshme për turistët me nevoja të veçanta*, duke i përfshirë në aktivitete të natyrës dhe të trashëgimisë kulturore;

j) *Projekte të turizmit*, që respektojnë mjedisin, si:

- “Gjelbëro dhe pastro”, duke mbjellë pemë për të kufizuar hedhjen e mbeturinave jashtë hapësirave të dedikuara për grumbullimin e tyre, në zonat e plazheve, në parqe natyrore etj.;

- Aktivitete artizanale nga popullsia lokale për krijimin e produkteve me materiale të riciklueshme që mund të shërbejnë si suvenire për turistë;

- Krijimi i instalacioneve për të mbledhur mbetjet plastike në zonat e plazheve;

- Ture sportive hiking, kayak, rafting, shëtitje me varka etj., *pa pagesë* për turistë që pranojnë të mbledhin mbetje gjatë itinerarit që përshkojnë;

- Evente lokale gjithëpërfshirëse me koncerte, lojëra dhe panele diskutimesh për ndërgjegjësimin mjedisor, shoqëruar me kulinari BIO dhe me metoda ekologjike;

k) *“Turizmi rinor”*, i cili synon përfshirjen e të rinjve në krijimin e eksperiencave të udhëtimit, turizmit, vullnetarizmit, si dhe aktivitete që promovojnë turizmin;

l) Aktivitete të përshtatura veçanërisht për fëmijët në plazhe, mbi rregullat dhe kujdesin lidhur me notin dhe sigurinë e larjes në det;

m) *Edukimin profesional të burimeve njerëzore* të subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit, me qëllim rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit, nëpërmjet trajnimeve etj.;

n) Mbështetja e strukturave provizore promovuese “Infopoint” gjatë sezonit turistik.



## PRIORITETI 2

### DIGITALIZIMI DHE INOVACIONI

Përmes këtij prioriteti do të mbështeten projekte të cilat nëpërmjet teknologjisë digjitale dhe metodave inovative zhvillojnë komponentë të turizmit, si: produktet turistike, atraksionet turistike, infrastrukturën turistike, shërbimin turistik dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari turistike.

*\* Tipologjia e aktiviteteve, që synojnë arritjen e prioritetit 2, renditen si më poshtë, **por** janë vetëm shembuj të cilët nuk kufizojnë tematika të tjera objekt i këtij prioriteti:*

- a) Hartëzimi dhe digitalizimi i burimeve/produkteve turistike;
- b) Identifikimi i vendndodhjeve dhe krijimi i itinerareve, *hartëzimi/digitalizimi i tyre*, për:
  - zhvillimin e sporteve ujore si lundrimi me kayak/kanoe/trap, rafting etj.;
  - zhvillimin e alpinizmit, skive dhe sporteve të tjera dimërore;
  - shënjimi i shtigjeve të reja për ecje dhe ciklizëm etj.;
- c) Aplikacione/platforma *online* që ofrojnë informacion mbi destinacione dhe atraksione turistike dhe krijojnë rrugë komunikimi për një target-grup të caktuar;
- d) Platformë *online* të bashkëpunimit për udhërrëfyesit turistikë, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

### II. PROCEDURA

Procedura e aplikimit bazohet në kriteret dhe afatet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “*Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit*”.

#### II.1 DOKUMENTACIONI

1. Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik, provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in, sa vijon:

- a) vërtetim nga Gjykata, Zyra Përmbartimore, që nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbartuesit;
- b) vërtetim nga Gjykata që nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga Gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
- c) vërtetim nga Gjykata dhe vërtetim të gjendjes gjyqësore që nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me

veprimtarinë profesionale, si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

ç) vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

d) vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

2. Dokumentacionin që demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të Projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, konkretisht:

- kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse;
- raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;
- kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

3. Në formularin e aplikimit të paraqesin argumente në mbështetje të propozimeve, që justifikojnë financimin e projekteve të rëndësishme të paraqitura prej tyre, si dhe argumente që çmimet janë të bazuara në referenca.

4. Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e Projektit.

5. Aplikuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) nëse aplikon si person fizik, duhet të paraqitet një CV dhe një portofol i veprimtarisë së aplikuesit;
- b) nëse aplikon si person juridik, duhet të paraqitet një CV e subjektit dhe një portofol i veprimtarisë së tij të deritanishme;
- c) vërtetim i llogarisë bankare të aplikantit;
- d) konfirmim për bashkëfinancimin e Projektit të propozuar (nëse ka).
- e) deklaratë e aplikuesit që nuk detyrohet për auditim ligjor të pasqyrave financiare (kur kjo është e aplikueshme).

*\* Kur aplikuesi është i huaj, ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kriteret e vendimit nr. 281, datë 13.4.2016, si dhe dokumentacionin e renditur më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.*

#### II.2 METODA E APLIKIMIT

Formulari i aplikimit i plotësuar, së bashku me



dokumentacionin mbështetës duhet të dorëzohen dorazi ose me postë, brenda datës 23 shkurt 2022, pranë protokollit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në adresën:

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1001, Tiranë  
Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

*Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Aplikim për përfitimin e mbështetjes financiare në fushën e turizmit; emri i aplikantit; titulli Projektit*

Sqarojmë se dokumentacioni i dorëzuar nuk mund të tërhiqet, por në rast interesi iu vihet në dispozicion fotokopje e tij.

### II.3 FINANCIMI

Fondi në dispozicion për këtë thirrje për projektpropozime është 75 760 000 lekë me TVSH.

Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të Projektit të pranuar e të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Projektet për të cilat kërkohet një financim, që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Financimi nga buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

Shpenzimet e nevojshme për shpërblimin e ekspertëve të pavarur do të mbulohen nga fondi buxhetor i parashikuar për mbështetjen financiare të projekteve turistike.

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### II.4 VLERËSIMI I KËRKESËPROPOZIMEVE

Vlerësimi do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2018, “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”.

Komisioni klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, pas përfundimit të afatit 30-ditor (tridhjetëditor) të parashikuar për paraqitjen e dokumentacionit nga subjektet e interesuara që kanë paraqitur kërkesëpropozime për mbështetje financiare. Procesi i përzgjedhjes së kërkesëpropozimeve kryhet në fazat e mëposhtme:

- vlerësimi i personit fizik/juridik dhe i

dokumentacionit të dorëzuar për plotësimin e kriterëve;

- vlerësimi i përmbajtjes së Projektit për subjektet që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë.

Ministri, brenda 5 (pesë) ditësh pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, miraton projektet në fushën e turizmit, të cilat do të përfitojnë financim.

Nëse kërkesëpropozimi përzgjidhet nga Komisionin i Përzgjedhjes së Projekteve dhe miratohet nga ministri, procedohet me njoftimin e aplikuesit, brenda 2 (dy) ditëve për nënshkrimin e kontratës.

Nënshkrimi i kontratës kryhet nga ministri ose një person tjetër i autorizuar prej tij.

Procesi i monitorimit të realizimit të Projektit të përzgjedhur, kryhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të Projektit.

## URDHËR

Nr. 21, datë 24.1.2022

### PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

## URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje



me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit do të jetë data 7.2.2022.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
Evis Kushi

**SHTOJCA NR. 1**  
**NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E**  
**ANËTARËVE TË BORDIT TË**  
**ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË**  
**MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR**  
**ARSIMIN NË UNIVERSITETIN**  
**“ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN**

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”; dhe të urdhrit nr. 21, datë 24.1.2022, të MAS-it, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin ‘Aleksandër Xhuvani’, Elbasan, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, si më poshtë:

| Nr. | Institucioni publik i arsimit të lartë     | Numri i anëtarëve për Bord Administrimi                                                                         |
|-----|--------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan | - 3 anëtarë përfaqësues të MAS-it<br>- 1 anëtar i përkohshëm deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve |

### 1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga senati akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë

ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

### 2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton



buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe të personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

### 3. Kërkesat e pranimit

#### a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;

- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

- të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi të largimit nga detyra;

- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

#### b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në

fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

- të ketë integritet etik dhe profesional;

- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;

- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

#### 4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- kërkesë për aplikim, ku të jetë specifikuar IAL-ja ku kandidon;

- jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (*CV – Curriculum Vitae*);

- fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën *Bachelor*). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të diplomës/certifikatës, i lëshuar nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- fotokopje të librezës së punës;

- fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;

- vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;

- formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;

- vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;



- vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

**5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër do të jetë deri në datën 7.2.2022, në një nga këto mënyra:**

a) me postë zyrtare, në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) dorëzimi dorazi, në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad hoc* të ngritur me urdhër ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

**6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur**

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).

**7. Masa e shpërblimit**

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

**SHTOJCA NR. 1/1**

**VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE DREJTUESE PARTIAKE**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrim \_\_\_\_\_

**SHTOJCA NR. 1/2**

**VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrim \_\_\_\_\_

**SHTOJCA NR. 1/3**

**VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI**

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrim \_\_\_\_\_

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

**Tiranë, 2022**